

MANASTIRI NJË QYTET OSMAN: STRUKTURA ADMINISTRATIVE DHE EKONOMIKE NË RUMELINË E SHEKULLIT XVI DHE XVII

(Galip Çağ, “*Bir Osmanlı Şehri Manastır: 16. ve 17. Yüzyılda Rumeli’de ve İdarî ve İktisadî Yapı*”, (Ankara: Selenge, 2020, f. 440)

Autori i monografisë “Manastiri një qytet osman: struktura administrative dhe ekonomike në Rumelinë e shekullit 16 dhe 17”, i takon vargut të studiuesve me prejardhje nga trevat e Ballkanit të sotëm, të cilët pas tërheqjes së Perandorisë Osmane nga këto anë në rrethana të rënda politike, u detyruan të migrojnë drejtë Turqisë së sotme.

Prof. asoc. dr. Galip Çağ, u lind më 1979 në Adapazar të Republikës së Turqisë nga një familje me prejardhje nga Kërçova e Maqedonisë së Veriut të sotëm. Shkollimin fillor dhe të mesëm e përfundoi në Adapazar. Studimet themelore në Universitetin *Gazi* të Ankarasë, ndërsa masterin dhe doktoraturën në Universitetin e Sakaryas në Adapazar të Turqisë. Ai është i specializuar në historinë e kohës së re (periudhë klasike osmane 1300-1800). Është ligjërues i lëndëve të Historisë së Ballkanit gjatë periudhës osmane. Ka qenë shef në Degën e Historisë dhe zëvendësdekan në Universitetin Gazi të Ankarasë dhe Çankër Karatekin (Çankır Karatekin Üniversitesi) të Turqisë. Kontributi i tij shkencor është i fokusuar në historinë e qyteteve shqiptare që sot janë pjesë e Maqedonisë së sotme Veriore.

Në vitin 2020 ka botuar monografinë mbi gjendjen administrative, ekonomike dhe sociale të Kërçovës në shekullin 16 [titulli origjinal: *16. Yüzyılda Osmanlı İdaresinde Bir Rumeli Şehri Kırçova/Kicevo, İdari-İktisadi-Sosyal Durum* [botues: Otorite Kitap], pastaj *Ballkani, pjesa tjetër e Evropës* [Titulli origjinal: *Avrupa’nın Ötekisi Balkanlar*, botues: Çankırı Karatekin Üniversitesi Yayınları, 2021] etj. Monografia mbi qytetin e

Manastirit të cilin po e prezantojmë, në vitin 2010 është mbrojtur si disertacion doktore në Departamentin e Historisë së Kohës së Re (periudhë osmane) në Degën e Historisë së Fakultetit të Letërsisë të Universitetit Sakarya të Turqisë dhe pas 12 vjetëve të mbrojtjes, u botua nën siglën e Shtëpisë Botuese “Selenge”. Monografia e autorit Çağ, trajton historinë administrative, sociale dhe ekonomike të njërit prej qyteteve më të rëndësishme të trevës evropiane të Perandorisë Osmane, siç ishte Manastiri.

Sipas praktikave metodologjike të historishkrimit, përveç parathënies, në strukturën e punimit në shqyrtim zënë vend hyrja e ndjekur nga tre kapituj, përfundimi dhe indeksi i emrave. Në hyrje, autori ka trajtuar tipat e qyteteve të para turke dhe zhvillimin e tyre deri tek qyteti osman. Në kuadër të hyrjes janë ofruar të dhëna mbi burimet e dorës së parë për historishkrimin e qytetit osman, ku bëjnë pjesë regjistrimet *tahrir*, *sixhil*, *muhimme* dhe ato *maliye*. Kapitulli i parë trajton historinë e përgjithshme të qytetit të Manastirit në periudhën paraosmane, rëndësinë ekonomike për zonën, pastaj i është kushtuar vëmendje e veçantë debatit ndërmjet historianëve rreth datës së pushtimit të Manastirit nga ana e osmanëve, e cila sipas autorit akoma nuk është e saktësuar, megjithatë ai konsideron se pushtimi duhet të ketë ndodhur ndërmjet viteve 1382-1385.

Në kuadër të këtij kapitulli, konform titullit të studimit, një trajtim i veçantë i është bërë Manastirit dhe Rumelisë gjatë periudhës së sundimit të Selimit I (1512-1520), Sulejmanit (1520-1566), i mbiquajtur Kanuni dhe Selimit III (1566-1574). Periudha të cilat lidhen me peshën e Manastirit gjatë kohës kur Perandoria ishte në pedestal dhe atë të rënies së fuqisë ekonomike dhe politike, e cila ndikoi edhe në humbjen e peshës së Manastirit si qendër e rëndësishme administrative e Rumelisë.

Në kapitullin e dytë i është kushtuar vëmendje vendit të Manastirit në kuadër të administratës osmane, ku janë ofruar të dhëna mbi numrin e popullsisë së qytetit gjatë vitit 1569, pastaj zhvillimin e mëhallëve deri në dekadën e dytë të shek. XVII. Në vazhden e këtyre të dhënave mbi mëhallët zënë vend edhe objektet fetaro-publik si pjesë e urbanistikës së qytetit. Për të vazhduar me aspektin ekonomik të tij, e ku janë ofruar të dhëna dokumentare mbi aktivitetin bujqësor dhe atë të zejtarisë. Kapitulli i tretë i është kushtuar rrethinës së Manastirit që kryesisht bëhet fjalë për të dhëna arkivore mbi të ardhurat e çifligjeve, bashtinave dhe prodhimeve bujqësore të fshatrave në

varësi të Manastirit, që përbënin një zë shumë të rëndësishëm për ekonominë e qytetit si dhe vetë thesarin e Perandorisë Osmane.

Në përfundim të këtij prezantimi të shkurtër të monografisë “Manastiri një qytet osman: struktura administrative dhe ekonomike në Rumelinë e shekullit 16 dhe 17” të autorit Galip Çağ, konkludojmë se, ky studim i bazuar në një gamë të madhe të dokumenteve arkivore osmane, si dhe literaturës së përzgjedhur të autorëve turq dhe atyre maqedonas, përbën një vlerë të madhe shkencore për historishkrimin e qytetit shqiptar. Aq më shumë që deri më tani historiografisë shqiptare i ka munguar një studim i këtyre përmasave mbi njërin nga qytetet e rëndësishme shqiptare që bart vlera të larta kulturore dhe historike për historinë shqiptare.

Agron ISLAMI